

V E N D I M

PËR REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Në Tiranë, sot më datë 06/03/1996, Unë Gjyqtarja e Gjykatës së rrethit Tiranë, pasi shqyrtova kërkesën dhe dokumentat e paraqitura nga kërkuesi Isuf Bega; për regjistrimin si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " ERZENI" Shpk, ortak i vetëm i së cilës është vetë kërkuesi,

K O N S T A T O V A :

Kërkuesi Isuf Bega ka paraqitur kërkesë, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë së përgjegjësisë së kufizuar " ERZENI" Shpk Ortak i vetëm, me qendër në katundin Samaticë të rrethit Berat, me administrator Isuf Bega, me kapital themeltar fillestar prej 100.000 lekë me kohë zgjatje të veprimtarisë saj mbi 10 vjet, me objekt zhvillimin e veprimtarisë private në fushën e tregtisë me shumicë e pakicë, eksport-import të artikujve të ndryshëm ushqimor, industrial, grumbullim e tregtim të artikujve bujqësor e blegtoral, tregtim artikuj elektrik, elektroshtepijake dhe paisje, materiale e lëndë ndërtimi, grumbullim e përpunim të dritharave, grumbullim dhe tregtim bimë medicinale, tregtim pije alkoolike, freskuese e birra, prodhim e tregtim të llojeve dhe asortimeve të ndryshme të bukëve.

Kërkesa është e drejtë dhe bazuar në ligjë, si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARËSYE:

Në mbështetje të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëri të tregtare" e ligjit nr.7667 datë 28.1.1993 " Për regjistrimin tregtar

V E N D O S A:

Regjistrimin si person juridik, të shoqërisë së përgjegjësisë së kufizuar " ERZENI" Shpk, Ortak i vetëm dhe administrator i së cilës është Isuf Bega, me banim e qendër në katundin Samaticë të rrethit Berat, me kapital themeltar fillestar 100.000 lekë, me kohë zgjatje të veprimtarisë mbi 10 vjet, me objekt zhvillimin e veprimtarisë private në fushën e tregtisë me shumicë e pakicë, eksport - import të artikujve të ndryshëm ushqimor, industrial, grumbullim e tregtim të artikujve të ndryshëm bujqësor e blegtoral, tregtim artikuj elektrik, elektroshtepijake e paisje, materiale e lëndë ndërtimi, grumbullim e përpunim të drithrave, grumbullim e tregtim të bimëve medicinale, tregtim pije alkoolike, freskuese e birra, prodhim e tregtim të llojeve e asortimenteve të ndryshme të bukëve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në shkallë të dytë.

G J Y Q T A R J A

Ilirion Tegu



14092

Procedures registrum:

No

1 1
2 (a) Erzemi "Jupa
(b) Samitice Beret.

(c) krypta o puelleve
ta # etj.

(c) 100 000 leke

3 Adm: Yusuf Bege, dtl. 1950
Lendur nu Samitice Beret.

4 Statute p/d/krmer dt 1301/10
Adm e. vitem. 6

5, dt 06 03 1996
Statute up. 3 felle

byptore
1996

AKT- THEMELIMI

Set në datë 12/01/1996 (nëntëdhjetë e gjashtë), unë Isuf Ali Bega, i datëlindjes 1950, lindur e bënues në katundin Samaticë të rrethit Berat, me dëshirën time, meqë plotësoj kushtet e parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare, morra vendim për të krijuar si " Ortak i vetëm" shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar " ERZENI" SHPK, qendra e shoqërisë " ERZENI" SHPK, është në katundin Samaticë të rrethit Berat.

Kapiteli themeltar fillestar është 100.000 lekë i depozituar pranë Bankës Tregtare Berat.

Kohë zgjatje e veprimtarisë shoqërisë është mbi 10 vjet, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë.

Shoqëria private " ERZENI" SHPK, është person juridik dhe aktiviteti saj zhvillohet në përpëthje me këtë akt-themelimi dhe statutin që i bashkëngjitet.

Objekti i veprimtarisë saj është në fushën e tregtisë me shumicë e pakicë eksport - import të artikujve të ndryshëm ushqimor, industrial, grumbullim e tregtim të artikujve bujqësor, blegtoral, tregtim paisje elektrike, elektroshtepijake, materiale e lëndë të ndryshme ndërtimi, grumbullim e përpunim të drithrave të bukës, grumbullim e tregtim të biomëve medicinale, tregtim pije alkoolike, freskuese e birra, si dhe prodhim të llojeve dhe asortimenteve të ndryshme të bukëve dhe tregtim të tyre, etj. që veçanësisht së bashku me të do jenë me leverdi për shoqërinë.

Këtë aktivitet, ajo do ta zhvillojë si " Ortak i vetëm" në shoqërinë " ERZENI" SHPK.

Këtë akt- themelimi e mbështes në kërkesat e ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 dhe pasi jë regjistruhem si person juridik në organet kompetente, Gjykatës të rrethit Tiranë e zyrën përkatëse tatimore, do të filloj zhvillimin e aktivitetit sipas objektit të parashikuar në statut dhe vendimin e gjykatës, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë së përgjegjësisë së kufizuar " ERZENI" SHPK.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit do të përmbahem statutit të hartuar për këtë qëllim, si dhe do respektoj dispozitat ligjore në fuqi e ato që do dalin në pas, për ushtrimin e veprimtarisë private në shoqërinë e përgjegjësisë së kufizuar " ERZENI" SHPK.

Shoqëria " ERZENI" SHPK, drejtohet nga administratori i saj që është " Ortaku i vetëm " Isuf Bega.

Ky akt themelimi, pasi u lexua nënshkruhet rregullisht para Komitetit Publik.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË " ERZENI" SHPK.

/ ISUF BEGA /

Isuf Bega

S T A T U T

I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE " ERZENI " SH.P.K.

E M Ë R T I M I

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare private " ERZENI " SHPK, eksport-import, me ortak të vetëm Isuf Ali Bega, i datëlindjes 1950. Lindur e banues në katundin Samaticë të rrethit Berat.

VEND QENDRIMI

Neni 2

Vend qendrimi i shoqërisë " ERZENI " SHPK, është në katundin Samaticë të rrethit Berat.

Shoqëria, në zhvillimin e aktivitetit të saj, mund të hapë dhe vendqendrimet të tjera, operative, filiale, agjensi në gjithë territorin e vendit, si dhe jashtë shtetit me miratimin e organeve kompetente.

KOHË ZGJATJA

Neni 3

Kohë zgjatja e shoqërisë "ERZENI" SHPK, është mbi 10 vjet, ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë ekonomiko tregtare është në fushën e tregtimit me shumicë e pakicë, eksport- import të artikujve të ndryshëm ushqimor, industrial, grumbullim e tregtim të artikujve bujqësor, blegtoral, tregtim paisje elektrike, elektroshtepijake, materiale e lëndë të ndryshme ndërtimi, grumbullim e përpunim të drithrave, grumbullim e tregtim të bimëve medicinale, tregtim pije alkoolike, freskuese e birra, si dhe prodhim të llojeve dhe asortimenteve të ndryshme të bukës dhe tregtim i tyre, e tj. që veças ose së bashku me këto do jenë me leverdi për rritjen e veprimtarisë së shoqërisë.

Megjithë këtë, shoqëria ka të drejtë të shtojë objektin e veprimtarisë së saj, me vendim të gjykatës së rrethit Tiranë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5

Kapitali fillestar themeltar i shoqërisë " ERZENI " SHPK, është në vlerë në shumën prej 100.000 lekë i depozituar në Bankën Tregtare Berat.

I gjithë kapitali i përket ortakut të vetëm Isuf Bega.

Neni 6

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet sipas vendimeve që do të marrë pronari i saj?

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 7

Shoqëria " ERZENI " SHPK, deklarohet e krijuar, në zbatim të plot

të normave që përmban ky statut dhe ato të legjislacionit Shqiptar në fuqi ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare" dhe aktëve të tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Ajo fiton zotësi për të vepruar, me regjistrimin e saj si person juridik në Gjykatë të rrethit Tiranë, ndërsa aktivitetin privat me regjistrimin në organet përkatëse financiare të rrethit, ku ajo ka qëndrën e saj

Neni 8

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje " Shoqëria ERZENI" SHPK, Eksport - import Berat.

Neni 9

Shoqëria merr përsëipër të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga aktet e administrimit. Ajo përgjigjet për detyrimet kontraktore e jashtëkontraktore brenda kapitalit të saj. Ortaku i vetëm i shoqërisë mbart rezikun e veprimtarisë së saj, në nivelin e shumës së mjeteve të investuara.

Neni 10

Shoqëria " ERZENI" SHPK, është pronë e Z. Isuf Bega, themeluesi i saj. Ai merr vendime në zbatim të ligjeve në fuqi dhe sipas këtij statuti, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë të punësharit në këtë shoqëri.

Zoti Isuf Bega, si pronar i shoqërisë është njëkohësisht dhe administrator i saj.

Neni 11

Administratori i shoqërisë, sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e veprimtarisë së shoqërisë, emron administrator dhe punëson punëtor të veprimtarive të ndryshme ekonomike, të përmendura në nenin katër të këtij statuti.

Neni 12

Administratori dhe përfaqësuesi i ngarkuar prej, janë të veshur me gjithë fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa asnjë kufizim. Ata kryejnë gjithë aktet që janë të nevojshme për realizimin e detyrave të saj. Ata kanë të drejtë, midis të tjerave të blejnë e të këmbëjnë pasuri, të lidhen me shoqëritë e tjera vendëse dhe të huaja, brenda e jashtë vendit. Të kryejnë çdo lloj operacioni e veprimi pranë gjithë zyrave private apo shoqërore, që kanë të bëjnë me garancitë, hipotekat, të kryejnë veprime depozitimi pranë instituteve bankare e financiare, kreditime e pagesa, arkëtime e tj.

Neni 13

Përfaqësuesi i shoqërisë " ERZENI" SHPK, i përket vetëm administratorit dhe përfaqësuesit të ngarkuar prej tij. Ata kanë të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë në organet gjyqsore e administrative, të caktojnë persona të tjerë me prokurë të posaçme, si dhe avokat për çështje në gjykim.

Neni 14

Mardhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështje që nuk gjejnë zgjidhje në këtë kontratë dhe për raste konfliktesh zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit të Shqiptar në fuqi.

Neni 15

Administratori i shoqërisë emron përfaqësuesin, të cilët në aktin e emrimit i përcakton detyrën dhe pagën. Po kështu, edhe për punëtorët, shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi, të punësimit dhe sigurimeve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 16

Përfaqësuesi nuk mund të marrë cilësinë e ortakut në shoqëri dhe as të ushtrojë aktivitet konkurrues të çdo lloji për llogori të tij ose të të tretve, përveç rasteve të autorizuar nga administratori.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 17

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe administratori nxjerr bilancin kontabel 31 të shoqërisë dhe llogorinë fitim humbje, mbështetur në rregullat e mbajtjes së kontabilitetit për subjektet private, të përcaktuara nga organet kompetente të sistemit fiskal. Bilanci kontabel miratohet nga administratori i shoqërisë, i cili vendos për krijimin e fondave të nevojshme për zhvillimin dhe garancinë e veprimtarisë së shoqërisë, si fondin e akumulimit, fondin rezervë e tj.

Neni 18

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve ligjore tëxpërbushura në nenin 19 dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale nga fitimi, i mbeten në prardorin pronarit të shoqërisë.

SHPËRBERJA E SHOQËRISË

Neni 19

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çdo shkak, si humbje e kapitalit, pamundësi veprimtarie e tj. Në këtë rast pronari i shoqërisë vendos për mënyrën e likuidimit dhe cakton një ose më shumë ekspert(likuidator), të cilët tregojnë kujdes që shoqëria të likujdojë më parë detyrimet që u ka personave të tretë fizik e juridik.

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 20

Për sa nuk shprehet në këtë statut i referohet plotësisht nga pronari shoqërisë, ligjit nr.7638 datë 19.11.1992

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË " ERZENI" SHPK.
/ Isuf Bega /

[Signature]



K Ë R K E S Ë

14092

KËRKUESI: Isuf Bega

OBJEKTI : Regjistrimi si person juridik i shoqërisë së përgjegjësisë së kufizuar " E R Z E N I " SH.P.K., në bazë të ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992" Për shoqëritë tregtare ".

GJYKATËS SË RRETHIT

T I R A N Ë.

Plotësoj kushtet që parashikon ligji sipërpërmendur për ushtrimin e veprimtarisë private. Për këtë kam themeluar shoqërinë e përgjegjësisë së kufizuar të emërtuar " E R Z E N I " SH.P.K.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jetë në fushën e tregtisë me shumicë e pakicë, eksport - import të artikujve ushqimor, industrial, grumbullim e tregtim të artikujve bujqësor e blegtoral, tregtim artikujve elektrik, elektroshtepijake dhe paisje , materiale e lëndë ndërtimi, gumbullim e përpunim të drithrave, grumbullim e tregtim bimë medicinale, tregtim pije alkoolike, freskuese e birra, prodhim e tregtim të llojeve dhe asortimenteve të ndryshme të bukëve.

Qendra e shoqërisë " ERZENI" SHPK, është në katundin Samaticë të rrethit Berat.

Kohë zgjatja e saj do të jetë mbi 10 vjet.

Kapitali saj themeltar është në shumën prej 100.000lekë.

Administrator i shoqërisë " ERZENI" SHPK, është " Ortaku i vetëm" Isuf Bega, themelues i saj.

Veprimtarinë e saj shoqëria " ERZENI" SHPK, do ta zhvilloj në përputhje me normat e statutit e aktin themelues të saj, të cilat i bashkëngjiten kësaj kërkesë, si dhe ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Shoqëria " ERZENI" SHPK, do të respektojë gjithashtu kërkesat e ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare".

Për sa më sipër kërkoj para Gjykatës së rrethit Tiranë regjistrimin si person juridik të shoqërisë së përgjegjësisë së kufizuar " ERZENI" SHPK.

*Ve regjistruar
Kërkesë
dt. 06.03.1996
Isuf Bega
Gjykatës*

K Ë R K U E S I
/ ISUF BEGA /

Isuf Bega

MARRVESHJE

MIDIS

DEGES BANKES KOMBETARE TREGTARE TE SHQIPERISE
NGA *Z. Ali Ibrahimi*.....

DHE
PERFAQESUESIT TE *"Erzem"*.....SH.P.K.(ne krijim e siper)
ZOTIT *Sauf Beqaj*.....

Me objekt:

Rregjistrimin juridik te fondeve te depozituara per llogari te shoqerise *"Erzem"*.....SH.P.K.(ne krijim e siper).

Palet bien dakort si me poshte:

1-Perfaqesuesi depoziton prane Deges Bankes Kombetare Tregtare te Shqiperise prej *100.000*.....lekesh ose USD, per llogari te shoqerise *"Erzem"*.....SH.P.K.(ne krijim e siper).

Kjo shume do te rrije e bllokuar ne keto llogari jo me teper se nje muaj (afat brenda te cilit gjykata eshte e detyruar ligjerisht te vendose ne lidhje me kerkesen e aplikantit) deri sa nga ana e tij te paraqitet ndermjet gjithë dokumentacionit te kerkuar nga Banka edhe vendimi i regjistrimit ne gjykate.

2-Dega e Bankes Kombetare Tregtare e Shqiperise pranon depozitimimin e shumes se mesiperme duke i dhene depozituesit (perfaqesuesit) certifikaten e depozitimit te fondeve me qellim qe ta paraqese ate ne gjykaten perkatese.

-Ne rast se perfaqesuesi kerkon te terheqe shumen e siperpermendur pa paraqitur dokumentacionin e kerkuar me siper duhet te ktheje mbrapsht certifikaten origjinale qe i eshte dhene atij per tu paraqitur ne gjykate.

4-Per sherbimin qe Banka do te kryeje do te zbatohen komisionet:

a-500 leke per SH.P.K. me kapital teresisht shqiptar dhe
b-50 USD per shoqerite e perbashketa(SH.P.K.) me kapital te huaj, pavaresisht nga raportet qe kane perqindjet e kapitalit ndaj partnereve.

5-Kjo marveshje nenshkruhet ne dy kopje prej te cilave secila nga palet merr nga nje.

Buat.....me *19/2/*.....1996

PERFAQESUESI

Sauf Beqaj

DEGA B.K.T.SH.

Ali Ibrahimi

